



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë-Albania, Tel/Fax: 04 2226814; 22268142

Nr. 272 Prot.

Tiranë, më 22.01.2015

V E N D I M

Nr. 2, datë 22.01.2015

Në mbështetje të neneve 11, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", si dhe neneve 80-104 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, mbi verifikimin e kryer në Bashkinë Cërrik,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në datë 24.12.2014, ka marrë dijeni për veprimin administrativ të kryer nga drejtuesi i Bashkisë Cërrik, lidhur me fillimin e një procedure disiplinore për nëpunësen ***** , me detyrë Inspektore e Administrimit të Aseteve e cila për momentin është zgjidhur me një vendim të ndërmjetëm për pezullimin e kësaj punonjëseje nga puna.

Duke qenë se në dokumentacionin e administruar, rezultuan të dhëna për shkelje të kryera e të lejuara, si nga komisioni i disiplinës ashtu dhe nga drejtuesi i bashkisë, me cilësinë e eprorit direkt, Komisioneri me urdhrin nr. 41/1 prot., datë 29.12.2014 filloi procesin e verifikimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të praktikës disiplinore në fjalë, dërguar nga administrata e Bashkisë Cërrik, rezultoi si më poshtë:

Kryetari i Bashkisë Cërrik me aktin administrativ nr. 71, datë 26.11.2014, mbi bazën e vendimit të komisionit të disiplinës me nr. 989/1 prot. datë 26.11.2014, ka urdhëruar pezullimin e marrëdhënies së punës për punonjësen ***** , deri në marrjen e një vendimi nga Komisioni i Shërbimit Civil.

Kjo procedurë disiplinore lidhet me një rast të pretenduar se, nëpunësja në fjalë në datë 26.11.2014 është sjellë në mënyrë të parregullt, duke përdorur shprehje të pahijshme përpara kolegëve dhe eprorëve. Më konkretisht, nëpërmjet një procesverballi që është mbajtur po në datë 26.11.2014, nëpunësit e Bashkisë Cërrik kanë parashtruar se, kolegja e tyre ***** është sjellë në mënyrë të parregullt; gjatë kohës së punës shqetësonte kolegët e zyrës dhe ato të zyrave të tjera, duke shkuar në zyrat e tyre pa patur arsye; është sjellë në mënyrë jo etike edhe me eprorët; është acaruar me shefin e administratës dhe situata është qetësuar me ndërhyrjen e policisë bashkiake. Në të njëjtën

ditë, është mbledhur komisioni disiplinor i institucionit i cili në mënyrë unanime ka vendosur pezullimin nga puna të nëpunëses. Më tej, titullari i institucionit ka nxjerrë urdhrin nr. 71, datë 26.11.2014 për pezullimin nga detyra të punonjësës *****
**** , deri në marrjen e një vendimi nga Komisioni i Shërbimit Civil.

Duke analizuar dokumentacionin që bën fjalë për këtë procedurë disiplinore konstatohet se, për këtë veprim administrativ, janë ndërmarrë këto hapa:

Së pari, është bërë raportimi me shkrim nga nëpunësit e institucionit, të cilët pretendojnë se kolegia e tyre vazhdimisht sillet në mënyrë të parregullt. (*Procesverbal nr. 993 prot., datë 26.11.2014*). Ky procesverbal përbën momentin e konstatimit të shkeljes disiplinore dhe gjendet në përputhje me Vendimin nr. 115, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i cili në Kreun II, pika 2 përcakton se: “Nëpunësit e institucionit, kur kanë dijeni apo dyshojnë për shkelje disiplinore, të kryera nga nëpunës të tjerë të të njëjtit institucion, duhet t’ia raportojnë atë me shkrim, eprorit direkt të nëpunësit për të cilin pretendohet se ka kryer shkeljen”.

Së dyti, është vendimi i komisionit disiplinor, i cili ka vendosur pezullimin nga puna të nëpunëses pasi është vlerësuar se vazhdimi i detyrës do të pengonte hetimin administrativ. (*Shkresa nr. 989/1 prot., datë 26.11.2014 vendim i komisionit disiplinor*).

Konstatohet gjithashtu se, që në fillimet e këtij procedimi janë lejuar mangësi lidhur me zbatimin e kërkesave procedurale të domosdoshëm për t’u kryer, kërkesa këto të përcaktuara në nenin 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe në Vendimin nr. 115, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, pikat nga 1 deri në 20.

Më konkretisht, nuk ka një relacion të eprorit direkt për fillimin e ecurisë disiplinore apo vlerësimin e shkeljes së pretenduar dhe nevojës që, rasti në fjalë të kalojë për shqyrtim nga komisioni disiplinor. Neni 59, pika 4 shkronja “a” e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” përcakton se “Komisioni disiplinor fillon procedimin: a) me kërkesë të eprorit direkt të nëpunësit civil. ...”. Në zbatim të kësaj dispozite, komisioni disiplinor nuk duhet të vepronte kryesisht për shqyrtimin e procedimit disiplinor, pasi për rastin konkret, ligji ka parashikuar se komisioni disiplinor vihet në lëvizje me kërkesë të eprorit direkt apo të subjekteve të tjerë të parashikuar në pikën 4 të nenit 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Së treti, vendimi i komisionit disiplinor për pezullimin e nëpunëses nuk ka dalë në përputhje me kërkesat e ligjit pasi, nuk ka të përcaktuar afatin se sa do të zgjasë pezullimi, dhe nuk është shprehur lidhur me detyrimin për të paguar nëpunësen në masën 50 për qind të pagës së plotë për gjithë periudhën që do të zgjasë pezullimi. Një detyrim i tillë është parashikuar në nenin 56 pika 4, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ku në mënyrë të shprehur thuhet: “... Në rastet e parashikuara në nenin 53 shkronja “c” dhe në nenin 54 shkronja “dh”, nëpunësi përfiton 50 për qind të pagës së plotë, ...”.

Në lidhje me aktin administrativ nr. 71, datë 26.11.2014, të Kryetarit të Bashkisë Cërrik në përmbajtjen e të cilit urdhërohet pezullimi i marrëdhënies së punës për punonjësën ***** vlerësojmë se, kryetari i bashkisë në nxjerrjen e këtij urdhri ka marrë

kompetencat e komisionit disiplinor pasi, veprimi i tij duhej të kufizohej vetëm me njoftimin e punonjësës lidhur me vendimin e komisionit disiplinor dhe jo të vepronte vetë si i tillë. Për më tepër, këtë vendim eprori direkt e ka lidhur me një kusht ligjor që nuk ekziston, kur shprehet *“deri në marrjen e një vendimi nga Komisioni i Shërbimit Civil”*. Institucioni i Komisionit të Shërbimit Civil, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” në bazë të nenit 70 të tij, ka mbyllur funksionimin, e në këto kushte, nuk mund të lidhet një akt administrativ me një kusht që nuk ekziston ligjërisht.

Duhet theksuar se, kur arrihet në përfundimin se, duhet të fillojë një ecuri disiplinore ndaj një nëpunësi, nga organi administrativ është e detyrueshme të respektohen procedurat e parashikuara në pikën 13 të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimim e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, të cilat i garantojnë nëpunësit të drejtën për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit; për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t’u asistuar; si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar. Nga verifikimi i procedurës së ndjekur është konstatuar se këto veprime nuk janë kryer nga organi administrativ duke mos respektuar të drejtat e nëpunësit civil.

Për sa u parashtrua më sipër, arrihet në përfundimin se, procedimi administrativ disiplinor i ndërmarrë nga Bashkia Cërrik, ku përfshihet si vendimi i komisionit disiplinor ashtu dhe nxjerrja e aktit të pezullimit ndaj nëpunësës ***** është kryer në kundërshtim me kërkesat e ligjit, e konkretisht, në kundërshtim me kërkesat e neneve 41 pika 1, 56 pika 4, 59 pikat 4 dhe 7 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; si dhe, pikën 13 të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimim e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”.

Për përmirësimin e situatës në bazë të nenit 124 pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative, duhet bërë revokimi i këtyre akteve, nga vetë organet që i kanë nxjerrë, duke rregulluar edhe pasojat që kanë sjellë këto akte.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbështetur në nenin 14, pika 1 dhe nenin 15 pika 1 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe nenin 124 pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative,

VENDOSI:

1. Paralajmërimin e Bashkisë Cërrik për përmirësimin e situatës, duke i lënë këto detyra:
 - Të revokohet urdhri nr. 71, datë 26.11.2014 i Kryetarit të Bashkisë Cërrik dhe vendimi nr. 989/1 prot., datë 26.11.2014 i komisionit disiplinor të Bashkisë Cërrik për pezullimin e marrëdhënies së punës për nëpunësen ***** .

2. Për realizimin e detyrës së mësipërme, lihet një afat prej 15 ditësh nga marrja
dijeni dhe në përfundim të këtij afati, të njoftohet Komisioneri për masat e marra.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA